

V E N D I M

Nr. 377, Datë 31.05.2001

PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

(Ndryshuar me vendimin Nr. 122, datë 17.02.2010)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutes dhe neneve 24 e 31, të ligjit Nr. 8457, Datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një shteti tjetër apo organizate ndërkombëtare, ndërmjet ministrive e institucioneve qendrore të vendit me homologët e tyre, të vendeve të tjera, me të cilët janë lidhur marrëveshje ndërkombëtare, të bëhet në përputhje me këto marrëveshje.

2. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), pranë Këshillit të Ministrave, është Autoriteti i Sigurimit Kombëtar në fushën e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”, me NATO-n, me shtetet dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

3. Para nënshkrimit të një marrëveshjeje, e cila përmban shkëmbim të informacionit të klasifikuar, duhet që:

a) institucioni shtetëror shqiptar, që do të jetë palë në marrëveshje, të marrë më parë, mendimin e DSIK-së ;

b) Shfuqizuar gwrma b, me vendimin Nr. 122, datë 17.02.2010

4. Shfuqizuar pika 4, me vendimin Nr. 122, datë 17.02.2010

5. Çertifikata e Sigurisë, e lëshuar nga Autoriteti i Sigurimit Kombëtar, të shtetit palë në marrëveshje, për të patur akses në informacionin e klasifikuar, është e vlefshme vetëm kur është lidhur një marrëveshje ndërkombëtare. *(Shfuqizuar fjalët “...për një person apo organizëm...”, me vendimin Nr. 122, datë 17.02.2010)*

6. Shfuqizuar pika 6, me vendimin Nr. 122, datë 17.02.2010

7. DSIK-ja, nuk do të lejojë akses (pra t’u japë të drejtë njohjeje) personave të tretë, për informacionin e klasifikuar, pa miratimin e Autoritetit të Sigurimit Kombëtar, të informacionit të klasifikuar, të vendit palë në marrëveshje.

8. DSIK-ja, autorizon me shkrim, hapjen në ministri dhe në institucione shtetërore, të zyrave të nënregjistrir të informacionit të klasifikuar të NATO-s, mbikëqyr veprimtarinë e tyre dhe vendos mbylljen e tyre, kur nuk respektohen standardet ligjore për sigurimin e informacionit dhe kur e gjykon të panevojshme, mbajtjen hapur të tyre. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar me NATO-n, kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga zyrat e nënregjistrir të informacionit të klasifikuar të NATO-s, të ngritura pranë ministrive dhe institucioneve shtetërore.” *(Ndryshuar pika 8, me vendimin Nr. 122, datë 17.02.2010)*

9. Transmetimi, transportimi dhe transferimi i informacioneve e i materialeve të klasifikuara të NATO-s, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, të kryhen vetëm përmes personave, rrugëve e mjeteve të përcaktuara dhe të certifikuara përshtatshëmrisht.” *(Ndryshuar pika 9, me vendimin Nr. 122, datë 17.02.2010)*

10. DSIK-ja dhe Autoriteti i Sigurimit Kombëtar të shtetit palë në marrëveshje, në përputhje me marrëveshjen ndërkombëtare, që kanë lidhur kanë të drejtë të ushtrojnë kontrolle për mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit të klasifikuar, në vendet respektive.

11. Për rastet e publikimit apo njohjes nga persona të paautorizuar të informacionit të klasifikuar, si dhe për rastet e vjedhjes, dëmtimit, shkatërrimit, humbjes, shkeljes së rregullave të sigurimit, etj., njoftohet menjëherë DSIK-ja dhe Autoriteti i Sigurimit Kombëtar të shtetit pale, në marrëveshje.

12. Për marrëveshjet dhe protokollet teknike, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, DSIK-ja, ka të drejtë të ushtrojë kontrolle, për mbrojtjen dhe sigurimin e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer.

13. Ministrinë dhe institucionet qendrore, janë të detyruar që një kopje të marrëveshjes për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, t’ia dërgojnë DSIK-së.

14. Ngarkohen titullarët e ministrive, institucioneve qendrore dhe DSIK-së, për zbatimin e këtij vendimi.

15. Përrjashtohen nga zbatimi i këtij vendimi, shërbimet informative brenda vendit, të cilat në marrëdhënie me shërbimet e huaja partnere, zbatojnë procedurat për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, sipas marrëveshjes që kanë lidhur.

16. Vendimi nr. 228, datë 4.4.1998, i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e Autoritetit Kombëtar për shkëmbimin e informacionit, me NATO-n” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I